



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:089877
Datë: 28.04.2022
Numri i dokumentit: 02961510

C.nr.629/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim Balaj me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses A.L. nga Gj., rruga..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë, vlera e kontestit 498.68 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, në të cilin prezantoi i autorizuari i paditëses, e në mungesë të te paditurës, me 28 prill 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.L. nga Gj. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në punë, për periudhën kohore 05.12.2015 – 31.08.2020, përkatësisht për 426 ditë pune, t’ia paguajë shumën prej 498.68 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 11.05.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 300.80 (treqind euro e tetëdhjetë cent), e këtë në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësja në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 11.05.2021 përmes të autorizuarit të saj, ka parashtruar se është e punësuar si mësimdhënëse e gjuhës angleze në SHFMU “S.” në Smolicë, në SHFMU “S.” në Gjakovë dhe në SHFMU “G.”, në Ponoshec, pranë Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjakovë. Ka parashtruar se e paditura në bazë të nenit 35 paragrafi 5

dhe paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK, me datë 18.04.2017 dhe me datë 22.01.2021, obligohet që punëtorëve të arsimit, përkatësisht këtu paditëses A.L., ti kompensoj 70% të çmimit të biletës së trafikut urban për shpenzime të udhëtimit, pasi që paditësja udhëton çdo ditë nga Gjakova për në fshatin Smolicë.

I autorizuari e paditëses gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë, provave të bashkangjitura në padi, duke shtuar se paditësja për periudhën nga data 05.12.2017 e deri më datë 31.08.2020, ka vijuar punën për 426 ditë dhe atë: në shkollën "S." në Dardani ka vijuar punën për 247 ditë, ndërsa në shkollën "S." në Smolicë, ka vijuar punën për 179 ditë për periudhën e lartcekur. Me propozim për gjykatën që pas administrimit të provave ta detyroj të paditurën që paditëses për periudhën nga data 05.12.2017 e deri më datë 31.08.2020, t'ia kompensoj 70% të shpenzimeve të udhëtimit në punë dhe atë shumën prej 498.68 euro me kamatë prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shumën prej 20,00 euro, për përpilimin e padisë, shumën prej 78,00 euro si dhe për përfaqësim në dy seanca gjyqësore shumën prej 202.80 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 300.80 euro.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin C.nr.629/21, të datës 01.07.2021 (*për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi*) padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 07.07.2021 (siç vërtetohet nga fletëkthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo deri në momentin e përpilimit të këtij aktgjykimi, nuk ka parashtruar përgjigje në padi, përkundër obligimit ligjor.

Gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditëses dhe në kuptim të nenit 423 paragrafi 4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të te paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor - publik, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: Kontratën e Punës, me nr. Prot. 14/0160, datë 13.11.2017, e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës; kontratën e Punës, të datës 05.12.2017, e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës;

Kontratën e Punës, me nr. Prot. 57/2018, datë 01.09.2018, e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës; Kontratën e Punës, të datës 01.09.2020, e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës; Kontratën e Punës, me nr. Prot. 57/2018, datë 02.09.2019, e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës; vërtetimin për ditët e prezencës në punë me nr. prot. 318/2021, datë 12.02.2021, i lëshuar nga SHFMU “S.” në Gjakovë; vërtetimin e lëshuar nga Shoqata e Transportit të udhëtarëve në Gjakovë, pa datë të lëshimit për relacionin Gjakovë-Dardani; vërtetimin e lëshuar nga Shoqata e Transportit të udhëtarëve në Gjakovë, pa datë të lëshimit për relacionin Gjakovë-Smolicë; kopjen e letërnjoftimit me numër personal... si dhe vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “S.” Smolicë, me datë 10.02.2020.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e bazuar në dispozitën ligjore nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga kontrata e punës, me nr. prot. 14/0160, datë 13.11.2017; kontrata e punës, e datës 05.12.2017; kontrata e punës, me nr. Prot. 57/2018, datë 01.09.2018; kontrata e punës, e datës 01.09.2020; si dhe kontrata e punës, me nr. Prot. 57/2018, e datës 02.09.2019, është vërtetuar rrethana se paditësja A.L., ka lidhur kontratë pune me të paditurën, Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, në vendin e punës: mësimdhënëse e gjuhës angleze, në shkollat fillore të mesme të ulëta “S.” në Gjakovë dhe “S.” në Smolicë – Gjakovë.

Me vërtetimin për ditët e prezencës në punë me nr. prot. 318/2021, datë 12.02.2021, i lëshuar nga SHFMU “S.” në Gjakovë, vërtetohet fakti se paditësja nga data 05.12.2017 e deri me datë 31.08.2020, gjegjësisht prej vitit shkollor 2017/2018 e deri në vitin shkollor 2019/2020, ka vijuar 247 ditë pune në SHFMU “S.” në Gjakovë, ndërsa 179 ditë pune në SHFMU “S.” në Smolicë – Gjakovë.

Me vërtetimin e lëshuar nga SHFMU “Sylejman Vokshi” Smolicë, me datë 10.02.2020, gjykata provoj faktin se paditësja në SHFMU “Sylejman Vokshi” në Smolicë, ka 5 orë mësimi në javë, gjegjësisht është e angazhuar 2 ditë në javë në këtë shkollë.

Nga vërtetimet e lëshuara nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, pa datë të lëshimit për relacionin Gjakovë-Dardani dhe relacionin Gjakovë-Smollicë, vërtetohet rrethana se çmimi i biletës së udhëtimit për relacionin Gjakovë Dardani është në lartësi prej 0.50 cent në një drejtim, ndërsa për relacionin Gjakovë Smolicë, çmimi i biletës së udhëtimit është në lartësi prej 1.30 euro në një drejtim.

Nga kopja e letërnjoftimit me numër personal... provohet fakti se paditësja A.L. me vendbanim është në Komunën e Gjakovës.

Gjykata lidhur me kërkesën e paditëses për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit gjatë ditëve të punës, vendosi duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 36 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, datë 18.04.2017, me të cilën është paraparë se: “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”, andaj bazuar në vërtetimet e administruara me lartë për ditët e prezencës në punë në të dy shkollat respektive, si dhe në vërtetimin e lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, paditëses ia njohu shumën e aprovuar sikurse në dispozitiv, duke bërë përlllogaritjen si në vijim dhe atë për shkollën “S.” në Dardani Gjakovë ($247 \times 0.70 = 172.90$) ndërsa për shkollën “S.” Smolicë – Gjakovë ($179 \times 1.82 = 325.78$), e në shumë të përgjithshme prej 498.68 euro.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditëses në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, me ç'rast paditëses iu pranuan shpenzimet siç në poshtë vijojnë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shuma prej 20,00 euro, për përpilimin e padisë shuma prej 78.00 euro, si dhe për pjesëmarrjen e të autorizuarit të saj dy seanca gjyqësore shumën prej 202.80 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 300.80 euro.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.629/21, me 28 prill 2022

GJYQTARI,

Durim Balaj

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.